



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.21/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: Ntsh"Victory Com&Company Murselishpk &Grand Construction shpk" - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE:"Drini Company & Berisha Com"-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e auto rrugëve Pjesa I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me numër të prokurimit: 632/18/6642/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Gjakovës, më datë: 05.02.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik:"Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e auto rrugëve Pjesa I-rë : Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me numër të prokurimit: 632/18/6642/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Gjakovës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull:"Mirëmbajtja e auto rrugëve Pjesa I-rë : Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me numër të prokurimit: 632/18/6642/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Gjakovës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Victory Com & Company Murseli & Grand Construction" - Gjakovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:14.09.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:08.10.2018, ku kanë marrë pjesë pesë(5) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik:"Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, si tenderues të eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt:19.10.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: "Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, me dt: 28.12.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 03.01.2019, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik:"Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues:"Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14 Janar 2019, me nr.21/19, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", me numër të prokurimit: 632/18/6642/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:59, 61, 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.01.2019, ka autorizuar ekspertinshqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Ekspertishqyrtues në raportin e dt: 25.01.2019, sqaron:

Lidhur me pretendimin ankimorë për korrigjimin e çmimit të OE ankues nga ana e AK-së, me rastin ofertimit OE ankues për tri pozicionet ka vendosur vlerën e TVSH-së prej 0.18€.

Lot I-rë: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane

Nr. i art.	Përshkrimi	Sasia km'	Çmimi për njësi	TVSH €	ÇMIMI TOTAL
Përqindja e pikave për vlerësim (ne %)		ÇMIMI TOTAL € (pas vlerësimit në përqindje)			
Pa TVSH €		ME TVSH €	ME TVSH €		
1.	Pastrimi nga bora dhe akulli	600	10.00	0.18	10.18
6,108.00	20 % (e pikëve në vlerësim)		1,221.60		
2.	Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhje të kripës	1000		145.00	0.18
145.18	145,180.00 60 % (e pikëve në vlerësim)		87,108.00		
3.	Vetëm hedhje të kripës	600	50.00	0.18	50.18
	6,021.60 20 % (e pikëve në vlerësim)				30,108.00
Totali i përgjithshëm:		100%			

Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlere). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike. 94,351.20

Në këtë rast AK ka bërë korrigjimin e vlerës së TVSH-së, duke caktuar vlerën e TVSH-së prej 18% për secilin pozicion, dhe pas këtij korrigjimi ka nxjerrur çmimin e OE prej 111.156€.

Ky kalkulim i AK-së është i saktë nëse merret për bazë vlera e TVSH-së prej 18%, mirëpo nuk qëndron arsyetimi i AK-së për eliminim të OE mbi bazën se ndryshimi në çmim është më i madh se 2%, sepse sipas përgjigjes së KRPP-së ndryshimi i vlerës së TVSH-së nuk përkufizohet si gabim aritmetik.

Tek pyetjet e shpeshta në KRPP-së lidhur me llogaritjen e gabueshme të vlerës së TVSH-së, përgjigja nr.46 shënon si në vijim:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Me gjithë faktin se çmimi i OE ankues pas korrigjimit të TVSH-së ndryshon, duhet cekur se edhe pas korrigjimit çmimi i OE nuk e tejkalon vlerën e parashikuar nga AK për Lot.1. Vlera e parashikuar prej AK-KK Gjakovë për lot.1 është 170,000€, ndërsa çmimi i OE ankues me korrigjimin e bërë prej AK është 111,156€. Do të thotë se edhe pas korrigjimit, çmimi i OE ankues është dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar nga AK. Në rastin konkret mendoj se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar sepse AK pa të drejtë e ka eliminuar OE ankues. Në rastin konkret AK pas korrigjimit të çmimit është dashtë të vazhdoj me vlerësimin më tutjeshëm të ofertës të OE ankues, andaj vlerësoj se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankimorë se AK nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr.629/18. Sipas shkresave të lëndës që kam pas në dispozicion, AK me rastin e rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin dhe pajisjet, mirëpo nuk ka kërkuar sqarime rreth çmimit të ofruar prej OE të rekomanduar për kontratë. Me vendimin e OSHP-së nr. 629/18, AK është dashtë të vlerësoj nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 61 të LPP dhe të zbatoj rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta. Sipas shkresave të lëndës nuk ndonjë provë se AK ka ndërmarr ndonjë veprim në këtë drejtim.

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e AK për pajisjet e kërkuara dhe stafin. Sipas shkresave të ofruara nga AK pas rivlerësimit, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithsej 11 libreza të qarkullimit për kamion. Kërkesë e AK-së ka qenë që 6 kamion të jenë për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës, ndërsa OE sipas shkresave të lëndës ka ofruar dokumentet unike doganore për pllugj/pastrues të borës dhe për shpërndarës të kripës sipas kërkesës së

AK. OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka ofruar kontrata për shitblerje të esakvatorëve sipas kërkesës së AK-së. OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin fillimisht ka pas 7 kontrata. Pas kthimit të lëndës në rivlerësim dhe sipas vendimit të OSHP për sqarime shtesë, AK ka kërkuar sqarime nga OE ku i njëjti ka ofruar sqarime dhe ka plotësuar kërkesën e AK. Andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Pajisje për të cilat nuk mund të gjinden dëshmi adekuate, lidhen me kërkesën e AK-së "Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini)". OE si në listën e prezantuar të pajisjeve, ashtu edhe në dokumentet unike doganore për këtë kërkesë ka paraqitur disa pajisje të emëruara "shpërndarës të kripës". Andaj vlerësoj se në këtë pikë OE nuk ka përmbushur kërkesën e AK-së.

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar aneksin 6, ky aneks ka të bëjë me listën e kontratave të realizuara të OE, dhe kjo listë është plotësuar nga OE sipas kërkesës së AK-së. Andaj vlerësoj se ky pretendim ankimorë është i pabazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues –KK-Gjakovës, me datë: 28.01.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "Victory Com&Company Murseli&Grand Construction" - Gjakovë, me datë: 29.01.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 05.02.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Krasniqi deklaroj: Ne si OE ankues sa i përket shpërblimi me kontrate OE "BERISHA" sipas pasqasjes tone ne dokumente zyrtare ka mungese të pajisjeve të kërkuara si ne FDT, dhe ne një dokument pajisje ju ka bashkëngjitur fotografite ndryshme ku janë kërkuara 6 pajisje. Ndërsa sa i përket te gjeturave ne lidhje me paramasen+pajtohem me ekspertin mirëpo dua te shtoj se ne paramasë te AK-së, ka mungesë te shumta nëse merret për baze qe ka thënë AK duhet te ekzistojnë edhe 2 kolona te tjera, dhe kërkojmë qe te aprovohet kresa dhe lënda te kthehet ne rivlerësim

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Gutaj deklaroj: Me disa pretendime pajtohem me mendimin e ekspertit, ndërsa nuk pajtohem kur ka llogaritur çmimin prej 2% ku është përmirësuar OE ka kaluar vlerën e parapare, Vlera parallogariture ka qenë 170.000 kurse OE ka ofruar 181.396.00 dhe kur përmirësuar TVSH ka kaluar 213.580 kurse OE ankues ne këtë pike është çmimi i poentuar, i bashkangjesimë edhe piken ku kërkohet shpërndarëset e kripës janë ofruar. Sa i përket OE te rekomanduar për kontrate i plotëson kërkesat e AK-se ku si pas ankuesit te shpërndarësit e kripës OE i rekomanduar ka 8 te tille, dhe tek shpërndarja e kripës mini nuk është kërkesë e AK-se dhe kërkojmë qe te hedhet poshtë kërkesa e OE dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Gjatë prezantimit në seance eksperti shqyrtues z. Halili deklaronë: Sipas shkresave të lendes qe kam pas ne dispozicion AK nuk e zbatuar ne tërësi vendimin e OSHP-së, ku përmes vendimit te OSHP-së, është kërkuar nga AK te kërkoj sqarime shtese rreth çmimit te OE Fitues. OE ankues ka gabuar ne kalkulim të TVSH-se, megjithatë TVSH nuk llogaritet si gabim aritmetikore. Qëndroj pas ekspertizës qe kam dhenë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se operatori ekonomik ankues pretendon se është eliminuar pa të drejt nga autoriteti kontraktues me arsyetimin se ka tejkaluar buxhetin e planifikuar nga njësia kërkesës, dhe çmimin për njësi nuk e ka llogaritur vlerën e TVSH-së prej 18%, dhe ka tejkaluar më shumë se dy (2%) të vlerës totale të ofertës , paneli shqyrtues sqaron se nuk qëndron arsyetimi i AK-së, për eliminim të OE ankues mbi bazën se ndryshimi në çmim është më i madh se 2%, sepse sipas përgjigjes së KRPP-së, ndryshimi i vlerës së TVSH-së, nuk përkufizohet si gabim aritmetik.

Paneli shqyrtues sqaron se tek pyetjet e shpeshta në KRPP-së, lidhur me llogaritjen e gabueshme të vlerës së TVSH-së, përgjigja nr.46 thuhet si në vijim:*Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.*

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe sqarime e ekspertit shqyrtues sqaron se çmimi i OE ankues pas korrigjimit të TVSH-së, ndryshon por duhet cekur se edhe pas korrigjimit çmimi i OE ankuese nuk e tejkalon vlerën e parashikuar nga autoriteti kontraktues për Lot.1. Vlera e parashikuar prej AK-KK Gjakovë, për lot.1 është 170,000€, ndërsa çmimi i OE ankues me korrigjimin e bërë prej AK është 111,156€. Do të thotë se edhe pas korrigjimit, çmimi i OE ankues është dukshëm më i ulët se vlera e parashikuar nga AK. Andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar për faktin se pa të drejtë është eliminuar OE ankues, ndërsa autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka vepruar në harmoni me neni 59 të LPP-së, ku pas korrigjimit të çmimit është dashtë të vazhdoj me vlerësimin më tutjeshëm të ofertës së OE ankues.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr.629/18, të dt: 30.11.2018, Paneli shqyrtues sqaron se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin dhe pajisjet, mirëpo nuk ka kërkuar sqarime rreth çmimit të ofruar prej OE-së, të rekomanduar për kontratë. Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion sqaron se në vendimin e OSHP-së me nr. 629/18, të dt: 30.11.2018, autoriteti kontraktues është dashtë të vlerësoj nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 61 të LPP-së, dhe të zbatoj rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta. Andaj sipas të gjitha shkresave të lëndës që kemi poseduar nuk ka ndonjë provë se AK ka ndërmarr ndonjë veprim në këtë drejtim, andaj me rastin e rivlerësimit AK-ja duhet të veproj në pajtim me nenin 61 të LPP-së dhe legjislacionin dytësor të KRPP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e AK-së, për pajisjet e makinerisë dhe stafin e punëtorëve ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion sqaron se sipas shkresave të ofruara nga autoriteti kontraktues pas rivlerësimit, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithsej 11 libreza të qarkullimit për kamion. Ndërsa kërkesë e AK-së, ka qenë që 6 kamion të jenë për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës, ku OE i rekomanduar për

kontratë ka ofruar dokumentet unike doganore për pllugj/pastrues të borës dhe për shpërndarës të kripës sipas kërkesës së AK. OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka ofruar kontrata për shitblerje të ekskavatorëve sipas kërkesës së AK-së. Ndërsa lidhur me stafin e OE-së, të rekomanduar për kontratë ku fillimisht ka pas 7 kontrata, ndërsa pas kthimit të lëndës në rivlerësim dhe sipas vendimit të OSHP-së, për sqarime shtesë, AK ka kërkuar sqarime nga OE ku i njëjti ka ofruar sqarime dhe ka plotësuar kërkesën e AK. Prandaj, paneli shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë “Drini Company & Berisha Com” – Prizren, pas rivlerësimit i ka plotësuar këto kërkesa të mësipërme ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues, në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj pretendim ankimorë i lartpërmendur është i pabazuar.

Paneli shqyrtues sqaron se pajisje për të cilat nuk mund të gjinden dëshmi adekuate, lidhen me kërkesën e AK-së “Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini)”. OE i rekomanduar për kontratë si në listën e prezantuar të pajisjeve, ashtu edhe në dokumentet unike doganore për këtë kërkesë ka paraqitur disa pajisje të emëruara “shpërndarës të kripës”, por jo sipas kërkesës e AK-së “Pastrues i borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini)”, Andaj paneli shqyrtues vlerëson se në këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e AK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë “Drini Company & Berisha Com” – Prizren, nuk e ka plotësuar aneksin nr.6, ku ka të beje me listën e kontratave të realizuara të OE-së, Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion vlerëson se pretendimi i OE ankues është i pabazuar për faktin se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar listën e kontratave ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues KK-Gjakovë, gjatë rivlerësimit nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me nr. 629/18, të dt: 30.11.2018, në përpikëri duke mos kërkuar sqarime të hollësishme dhe të detajuara se si do ta realizoj këtë kontratë OE i rekomanduar për kontratë, prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të kërkojë sqarime në lidhje me çmimin e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues, obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit duhet që ta ketë parasysh nenin 61 të LPP-së, dhe paragrafin 4.4 të nenit 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe tu

përmbahet në detaje të gjitha kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht ti zbatojë të gjitha dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi e tenderëve ta bëjë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -Kuvendi Komunal i Gjakovës

1x1 OE -"Victory Com & Company Murseli & Grand Construction" - Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.